

# APIS

Shoqata Bletare Informativ dhe Këshilldhëse

## APIS

Është revistë periodike informative apikulturore që përgatitet si rezultat i realizimit të pilot proektit: "Ngritja e shërbimit privat këshillues në bletari në R. e Maqedonisë". Financiarisht i mbështetur nga MAASP (Proekti për zhvillimin e shërbimeve këshilluese bujqësore në Maqedoni), i koordinuar nga qendra e repro-trajnimit APICENTAR (APIQENDËR) dhe Fakultetit të Shkencave Bujqësore dhe Ushqimit në Shkup.

Sh.B. NEKTAR – Manastir

Vasko Karadakovski

Sh.B. BRATSTVO - Prilep

Dejan Boshkoski

Sh.B. MATICA - Shkup

Ivan Dodevski

Sh.B. MATICA - Vinicë

Ilčo Kostadinovski

Sh.B. PÇELLA - Kumanovë

Sreçko Stankovski

Sh.B. MLEÇ- Strumicë

Vojislav Katranxhiev

Sh.B. MALEShEVSKA PÇELLA –

Berovë

Emilija Rushkovska

Sh.B. PÇELLA – Probishtip

Goran Gjurovski

Sh.B. SHAROPIN – Gostivar

Mersel Xhaferi

Sh.B. ZLATNA MATICA - Kavadar

Pere Rizov

**Redaktorë i APIS:**

Vasko Karadakovski

**Ndihmës redaktorë:**

Sreçko Stankovski

**Redaktorë i APIS (Gjuhë Shqipe)**

Valon Mustafi

**E shpallur në:**

[www.apicentar.com.mk](http://www.apicentar.com.mk)

[www.pcela.mk](http://www.pcela.mk)



Më 04.09.2010 në Manastir, Bordi Menaxhues i L.Sh.B.M.-së mbajti mbledhjen e dytë me rradhë, ku përveç anëtarëve morrën pjesë edhe mysafir tjerë e ndër ta edhe Andreja Sekulovski. Në mbledhje u diskutua për 10 pikat e rendit të ditës

Kryetari Pavle Boshkovski paraqiti raportin mbi problemet nëpër të cilat kalon LShBM.-ja gjatë regjistrimit në Regjistrin Qendrorë të Maqedonisë. Ai potencoi se një ndër problemet ka qenë edhe emri, sepse në regjistër ende egziston Lidhja e vjetër (LBM). Si pengese tjetër është paraqitur ndalesa e personave juridik të jenë themelues që defakto përjashton edhe firmat dhe Fakultetin e Bujqësisë nga lista e themeluesve të LShBM-së.

Poashtu në mbledhje u fol edhe për rekoltën e mjaltit apo mjaltdhënien për vitin 2010, të cilën e kishin paraqitur edhe kryetarët e shoqatave në raportet e tyre.

Më tepër në fq. 3

## Lajmërim nga Shoqatat e Bletarëve

### Sh.B. NEKTAR - Manastir

Organizon vizitë në Saemin Tashmajdan në Beograd. Nisja do të bëhet me datë 01.10.2010, ora 20:00 nga Manastiri. Kthimi nga Beogradi do të jet me 02.10.2010

Për më tepër informata, tel: 075 54 08 34 , Milan Mrnzevski.

Vasko Karadakovski

### Sh.B. BRATSTVO – Prilep

Më 23.09.2010, e enjte në sheshin e qytetit në Prilep do të mbahet manifestimi "Mjaliti dhe produktet tjera të bletëve, investim në shëndetin tuaj" dhe do të vazhdoj deri më 25.09.2010. Pjesëmarrja në manifestim do të kushtoj 300 den + 1kg mjaltë. Të interesuarit duhet të paraqiten më vonë deri më 20.09.2010 në nr. tel: 075 55 51 30 dhe 070 65 56 09, ose në e-mail:

[boskoski.dejan@yahoo.com](mailto:boskoski.dejan@yahoo.com)

Дејан Бошкоски

### Sh.B. MALEShEVSKA PÇELA – Berovë

Më 26, 27 dhe 28 Gusht 2010 në sheshin e qytetit të Berovës u mbajt manifestimi vjetorë "Maleshevijska në pëllëmbë". Kjo shoqatë u paraqit me disa shtande në të cilat përveç tjerash u ekspozuan edhe bimë mjaltdhënëse.


Емилија Рушковска

### Sh.B. MATICA – Shkup

Organizon saem të mjaltit, i cili do të mbahet më datë 30.09, 01.10, dhe 02.10 2010.

Иван Додевски

## Ndërrimi dhe dhënia e matkës



Njëri ndër problemet më të ndërlikuara në bletërimin praktik është ndërrimi ose zëvendësimi i matkës së vjetër me matkë të re. Shpesh herë edhe bletarët më me përvojë hasin në këso vështirësishë. Ndodh që një metodë e njejtë e ndërrimit të jap rezultate të ndryshme. Pra, nuk egziston asnjë metodë apo mënyrë e cila do të ishte 100% e suksesshme. E gjithë kjo mund të jetë rezultat i pagabueshmërisë së bletëve në njohjen e amës së tyre, sepse asnjëherë nuk egzistojnë dy matka të njejtë, prandaj gjatë dhënies së matkës së re ndodh që bletet të shfaqin sjellje agresive ndaj saj. Gjatë zëvendësimit të amës së vjetër me amë të re të pambarsuar, në 98% të rasteve kjo e fundit mbytet nga bletët.

Nëqoftëse një shoqëri e humb amën e tyre, mungesën e saj shumë shpejt do t' a vërejnë. Nëse në

atë moment kësaj shoqërie i jepet amë e re, bletët do t' a vërejnë ndryshimin e saj nga ama e tyre e parë. Prandaj bletarët në këso rastesh duhet të intervenojnë duke krijuar kushte që pranimit i matkës së re të jetë i suksesshëm: së pari matka e re vendoset në kafaz special i cili shërben për t' a mbrojtur atë dhe njëkohësisht mundëson komunikimi më të sigurt në mes bletëve dhe matkës. Poqëse bletët fillojnë që amën e re t' a ushqejnë, pranimit mund të jetë i suksesshëm. Por gjithashtu ka edhe shoqëri të cilat assesi nuk pranojnë që zëvendësimin t' a kryejë dikush tjetër përpos vet atyre.

Tani do të përmendim kushtet e nevojshme të cilat duhet të plotësohen dhe të kihen parasysh gjatë ndërrimit dhe dhënies së matkës:

1. Ama e vjetër s' duhet të jetë prezente në shoqëri, pra e njejtë duhet paraprakisht të menjaherë.
2. Para vendosjes së kafazit në shoqëri, nga i njejtë duhet t' i largojmë bletët përcjellëse sepse mund t' a vështirësojnë procesin.
3. Kafazi vendoset në mes të shoqërisë në koshere dhe nëpërmjet vrimave të tij mundësohet komunikimi.
4. Hyrja e kafazit duhet të jetë e mbyllur me brum sheqeri (pogaçe), të cilën pas 3-4 ditëve bletët do t' a hapin e në këtë mënyrë do të jenë në kontakt të drejtpërdrejtë me matkën e re.

Mënyra më e sigurt e ndërrimit të amës është që ajo të mbyllet në kafaz të posaçëm në vet kornizën me hoje me larva të mbyllura, ashtu që tani amës së re do t' i mundësohet që të bëjë ve në qelitë e lira brenda kafazit.

Një mënyrë tjetër mjaft e suksesshme dhe e sigurt është që bletari të formojë nukleuse me bletë të reja dhe matkë të re e të njejtin më vonë t' a ribashkojë me shoqërinë amë të cilës ia kemi larguar matkën.

Ja disa arsye përse bletët nuk i pranojnë gjithmonë matkat e reja:

- moshë e bletëve: agresiviteti i shoqërisë ndaj amës së re varet nga struktura e moshës së bletëve. Është e njohur se bletët e reja janë më të sjellshme dhe nuk tregojnë aspak rezistencë ndaj amës së re.
- më vështirë amat e reja pranohen në periudhën e rojtitjes, si dhe gjatë muajve korrik dhe gusht sepse gjatë këtyre periudhave të shumica e bletëve zhvillohen vezoret.
- gjithashtu shoqëritë tek të cilat janë prezente matkat e rrejshme nuk tregojnë aspak vullnet për të pranuar amën e re.

Katranxhiev Vojislav  
Shoqata e bletarëve MLEÇ - Strumicë

## Aktivitetet mujore në bletore (kopshtin e bletëve)

### Shtatorë

Në këtë muaj duhet të kryhen të gjitha punët e mbetura nga muajt e kaluar. Duhet t' u bëhet kontroll shoqërive e pastaj poqëse është e nevojshme të merren masa për përgaditjen për dimërim.

Nga kosherja mund të menjaherë kornizat e mesme nëse në to nuk ka ushqim të mjaftueshëm. Nëqoftëse ka disa korniza të tilla dhe në to ka poashtu edhe larva, atëherë ajo që ka më pak ushqim (e mesit) largohet në skajet e lëmshit të bletëve ku edhe do të lindin bletët e reja dhe të njejtën kohë afrohen kornizat me më tepër mjalte sa më afër lëmshit. Bletët në shoqëritë më të vogla (me numër) nuk duhet të jenë të shpërndara në tërë kosheren, por të jenë të koncentruara kah mesi i kosheres në aq korniza sa që do të mund t' i mbulonin, në të cilat ka sasi të konsiderueshme të ushqimit. Kornizat me hoje të dëmtuara, të këqija e me deformime, si dhe ato me hoje të reja duhet të largohen nga kosherja e bletëve. Në të dyja skajet e lëmshit është e nevojshme të ketënga 1 kornizë të plotë me mjalte, ndërsa tea to më të dobëta, si dhe te ato më të zhvilluarat nga 2 korniza të mbishura me mjalte.

Në koshered e tipit LR (Langstroth-Root) dhe FA (Farrar) këshillohet që lëmshi dimëror i bletëve të formohet në katin e dytë ashtuqë një pjesë e saj të jetë në kontakt me mjalutin.

Ushqimi me sherbet duhet veçmë të përfundojë. Ushqehen vetëm ato shoqëri që kanë nevojë edhe atë me sirup sheqeri (sherbet) me porcione më të mëdha e në kohë më të shkurtë. Shoqëritë e bletëve me çdo kusht duhet të trajtohen kundër varroas nëqoftëse deri tani s' janë trajtuar. Gjatë trajtimit antivarroa duhet të përcillet intenzitet dhe efikasiteti i rrënjës së varroas e nëqoftëse e njejtë është i dobët atëherë duhet të ndërrohet preparati.

Gjatë kontrollimit të koshereve duhet të verëhet gjendja shëndetësore e shoqërive, veçanërisht sëmundjes amerikane të larvave. Nëse vërejmë korniza të infektuara me larva të gëlqerizuara, të njejtat largohen nga kosherja dhe hojet e tyre shkrihen. shoqëritë me simptome të tilla evidentohen e në pranverë ndiqet zhvillimi i tyre me kujdes.

Shoqëritë e bletëve pa matka ose me matka të rrejshme bashkohen ose shpërndahen në shoqëritë tjera.

Gjithashtu gjatë këtij muaji duhet të kujdesemi edhe për bletoren në përgjithsi duke mbajtur pastërtinë dhe rendin (kositet bari, kontrollohen mbajtëset e koshereve, etj.). magazinat e mjaltit (mjaltoret) vendosen në vende të sigurta dhe izoluara nga minjtë dhe mola e dyllit (është mirë që ky vend të rrihet nga promaja).

Vasko Karadakovski Sh.B. NEKTAR - Manastir



### Çka mëtutje!...

Në strumicë tregjet janë të mbushura me mjaltë të falsifikuar e jo të pastërt, i cili shitet si mjaltë natyral me çmim më të ulët. Si shoqatë këkuam ndihmë nga Inspektorati i Ushqimit në Komunën e Strumicës me qëllim që të ndërpritet kjo dukuri. Por, përgjigjja e tyre ishte se nuk qenkan kompetentë dhe na drejtuan te Inspeksioni Veterinar pran Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujrave në komunën e Strumicës. Por, edhe atje na than se kjo punë s'është nën kompetencën e tyre e përsëri na drejtuan te inspektorati i mëparshëm...

Ne si shoqatë kemi hequr dorë nga kjo iniciativë dhe pyesim, çka mëtutje?!

Katranxhiev Vojislav  
Sh.B. MLEÇ - Strumicë

Vazhdon nga fq.1

**Manastir:** Kryetari Milan Mmzevski theksoi se ky vit ka qenë i dobët sa i përket mjaltdhënies. Mesa tarja për Manastir ka qenë nën 10kg për koshere.

**Prilep:** Njejtë si në Manastir; vit më dobët në krahasim se viti i kaluar, me mesa tare prej 5-10kg.

**Probishtip:** Bletarët kryesisht të kënaqur. Mesa tarja prej 20-25kg për koshere. Kryesisht mjal ti është nga draka.

**Kratovë:** Për Kratovë foli Aco Todorovski, pronari i web faqes [www.pcelar.mk](http://www.pcelar.mk). Mesa tarja ka qenë rreth 5kg. Mjaltdhënija ka zgjatur rreth 10-15 ditë, në përgjithsi nga livadhet dhe murriz (dri zë) (*Paliurus aculeatus*). Poashtu ai potencoi se duhet t'i përkushtohet rëndësi më e madhe florës në Maqedoni.

**Vinicë:** Mesa tarja ka qenë 5,5kg. Dushku aspak nuk ka dhënë mjaltë, ndërsa Onopordum acanthium këtë vit ka në qenë më mjaltdhënëse se zakonisht.

**Strumicë:** Ky vit ka qenë i mirë. Mesatarja ka qenë prej 20-25kg për koshere, nëqoftëse llogariten vetëm shoqëritë prodhuese të bletëve.

**Kavadar:** Shumë më pak se vitet e kaluara. Mesa tarja rreth 5-7kg.

**Berovë:** Mesa tarja ka lëvizur prej 4-5kg vetëm nga livadhet. Për dallim nga vitet e kaluara, sivjet ka qenë më mirë.

**Ohër:** Në pranverë shoqëritë janë zhvilluar mjaft mirë, por pastaj në mjaltdhënie ka qenë dobët. Mesa tarja 4-5kg.

**Shkup:** Ngjajshëm si në vendet tjera të Maqedonisë. Mjaltdhënie ka pasur kryesisht në vendet me lartësi mbidetare nën 500m.

Poashtu u bisedua edhe rreth problemeve të sëmundjeve të bletëve dhe për zgjidhjen e tyre. U sollë disa vendime, mes të cilave:

- Të kërkohet nga Ministria të bëhet lista e barrërave, të cilat mund të përdoren në shërimin e bletëve.
- Të fomohet trupi punues për luftën kundër sëmundjeve të bletëve, e cila sëbashku me përfaqësuesit e Federatës së Farmerëve të R. së Maqedonisë (FFRM) do të bashkëpunoj me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujrave (MBPEU).
- Të kërkohet dhe punohet për sjelljen e ligjeve për bletarinë.
- Të aktvizohen shoqëritë e bletarëve për trajtimin e njëhershëm nëpër regjioneve.